

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MY TRIP & TOUR"**

Ne Tirane, sot me datë 29/10/2024 , **Perparim Nika** person me shtetësi shqipëtare, i datëlindjes 11.02.1985 mbajtës i kartës së identitetit me Nr. **I50211040K** i cili me zotësi të plotë juridike per të vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"MY TRIP & TOUR"** SH.P.K.

**Neni 1
Forma e shoqerise**

Ortaku themelon një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e tij eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

**Neni 2
Emertimi i shoqerise**
Emertimi i shoqerise eshte **"MY TRIP & TOUR"** SH.P.K.

**Neni 3
Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

4.1 Veprimtaria e Shoqerisë **"MY TRIP & TOUR"** SH.P.K.do të ketë për objekt :

- Transport rrugor nderkombetar te udhetareve.Transport rrugor brenda vendit te udhetareve. Agjenci udhetimi. Operator Turistik. Kryerja e sherbimeve te rregullta te specializuara te transportit te udhetareve brenda vendit. Agjenci transporti nderkombetar te udhetarve. Agjenci transporti udhetaresh me autobus dhe taksi brenda vendit. Transport rrugor te mallrave per vehte dhe per te trete brenda dhe jashte vendit, tregeti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial dhe ushqimore, import dhe eksport i tyre. Organizim eventesh. Veprimtari turistike si agjenci turistike udhetimi per kryerjen e sherbimeve dhe

Perparim Nika

udhetimeve turistike me turiste te huaj dhe vendas, individe ose te organizuar ne grupe, brenda dhe jashte vendit. Sherbime sipas guidave te udhetimit, prenotim dhe akomodim hoteli. Sherbime te dhenieve me qera te mjeteve me dhe pa drejtues te mjeteve.

4.2 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

4.3 Shoqëria, me vendim të ortakut mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortakët, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

4.5 Objekti i shoqërisë mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te ortakut.

Neni 5 Selia

Selia e Shoqërisë "MY TRIP & TOUR" SH.P.K është ne adresen:

Njësia Administrative Nr.11, Rruga Eshref Frashëri, Pallati LNK, Kati 4, Tiranë.

Shoqëria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë "MY TRIP & TOUR" SH.P.K është 100 000 (njqindmije) Leke, dhe zoterohet 100% nga administratori **Perparim Nika** person me shtetësi shqipëtare, i datëlindjes 11.02.1985 mbajtës i kartës së identitetit me Nr. **I50211040K**.

Neni 8
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë:

Perparim Nika person me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 11.02.1985 mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 150211040K me afat 5 vjet.

Neni 9
Viti financiar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Përfshihet, viti i parë financiar do të fillojë nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe do të mbyllet në fund të vitit përkatës.

Neni 10
Te ardhurat neto

Te ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në raport me kuotat e tyre në kapitalin fillestar. Te ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimi, në perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit të tatimeve, dhe rezervës së domosdoshme, të konkretizuara në bilancë, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 11
Juridiksioni

Te gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirekuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, është hartuar në 3 kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

Perparim Nika

Ortaku i vetëm

Perparim Nika
Ortaku i vetëm